

VENDIM
Nr. 322, datë 15.4.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTEVE NË PARKUN E VIROIT “SISTEMIM I PARKUT TË VIROIT, RIKONSTRUKSION I RRUGËS NË PARKUN E VIROIT NGA ANA E QYTETIT, NDRIÇIM I TROTUARIT NË PARKUN E VIROIT NGA ANA E QYTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në parkun e Viroit, “Sistemim i parkut të Viroit, rikonstruksion i rrugës në parkun e Viroit nga ana e qytetit, ndriçim i trotuarit në parkun e Viroit nga ana e qytetit”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Gjirokastrë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “sipërfaqe kullimore”, “objekt” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 7 194 853 (shtatë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 7 194 853 (shtatë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh të përballohet nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë në datën 20.4.2015.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Gjirokastrë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastrë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë dhe Bashkia Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PROJEKTE NË PARKUN VIROIT" (1) SISTEMIM I PARKUT TËVIROIT
(2)RIKONSTRUKSION I RRUGËS NË PARKUN E VIROIT NGA ANA E QYTETIT,
(3)NDRIÇIM I TROTUARIT NË PARKUN E VIROIT NGA ANA E QYTETIT

Emri/mbi emri	Numri i pasurisë për shpronësim	Objekte ndërtimit	Toke/T ruall m2	Tokë bujqësore (Kullo te) m²	Vlerë ndërtëse	Cmimi per m² (lekë) truall/ toke bujqësore	Vlera totale (lekë)	Institucioni që inicion shpronësimit	Statusi i procesit për shpronësim
Gezim Cabej	310/13, ZK Grehot Virua	-	-	865		164	141,760.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/14, ZK Grehot Virua	-	-	542		164	88,888.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/15, ZK Grehot Virua	-	-	678		164	111,192.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/16, ZK Grehot Virua	-	-	320		164	52,480.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/17, ZK Grehot Virua	-	-	278		164	45,592.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/18, ZK Grehot Virua	-	-	250		164	41,000.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/19, ZK Grehot Virua	-	-	1500		164	246,000.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/20, ZK Grehot Virua	-	-	2245		164	368,180.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/21, ZK Grehot Virua	-	-	2815		164	461,660.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/22, ZK Grehot Virua	-	-	3040		164	498,560.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/23, ZK Grehot Virua	-	-	3100		164	508,400.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/24, ZK Grehot Virua	-	-	8675		164	1,422,700.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Gezim Cabej	310/25, ZK Grehot Virua	-	-	300		164	49,200.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Shefqet Shehu	310/29, ZK Grehot Virua	90	420	-	527,509	4865	2,570,809.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Trashgimtarë Familja Shtino	45/8, ZK Grehot Virua	-	-	3180		164	521,520.00	Bashkia Gjirokastrë	Konfirmuar nga ZVRPP
Leander Noti	45/2, ZK Grehot Virua	-	-	408		164	66,912.00	Bashkia Gjirokastrë	Saktësim dokumentacioni
						Total =	7,194,853.00		